REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.184 dt.15.12.1997

PER
MIRATIM FONDI PER SHPERBLIMIN E FAMILJEVE
PER RASTE FATKEQESIE.

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, i mbledhur sot me dt.15.12.1997, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Organizim Personelit "Për miratim fondi për shpërblimin e familjeve për raste fatkeqësie", në zbatim të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", Ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 "Për buxhetin lokal" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre

VENDOSI

1. Të miratoj përdorimin e fondit prej 200.000 lekë për shpërblimin e familjes së Bilal Sula nga fondi rezervë i Bashkisë së Tiranës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Organizim Personelit dhe Drejtoria e Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI